

MIMOZA MANXHARI

QEVERISJA JE TI

BOTIMET TOENA
Tiranë

*Mirënjohja ime më e përzemërt për:
Ilirin dhe Suzin, pranë e prezent edhe në këtë libër.
Z. Ponari dhe znj. A. Cokani, të cilët duke mbështetur bujarisht
botimin e këtij libri, dëshmuar në besimin që kanë për ndikimin
transformues të qytetarëve të mirëarsimuar në përparimin shoqëror.*

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Edona Marku Huqi
Korrektore letrare: Sonila Kryeziu
Përkujdesja grafike: Adriana Matraku
Kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 9789928817044

©Autorja

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA
Rr. "M. Gjollesha", K. Postare 1420, Tiranë
Tel.: + 355 4 22 40 116
Email: botimet.toena@gmail.com
toena.porosionline@gmail.com
<https://toena.al>

Prindërve të mi,
të cilët më rrënjosën besimin
se mund të bëhesha gjithçka isha
dhe me plot dashuri më mësuam se,
nuk mjafton vetëm të zbulosh,
duhet dhe fort të punosh
e, mbi të gjitha,
të tolerosh dhe
të durosh.

“E vetmja dije e vërtetë,
është të dish se nuk di asgjë”,
Sokrati¹

Libri “Qeverisja je ti”, është produkt i një pune mbi 25-vjeçare mësim-dhënieje në kursin e nivelit master në Administrim Publik, në Universitetin e Tiranës, periudhë gjatë së cilës më është dhënë mundësia të kërkoj dhe hulumtoj mbi strukturat që kompozojnë dhe ndikojnë në funksionimin e jetës shoqërore.

Ka qenë sfidë, por më ka bërë vetëm mirë.

Personalisht, e kam ndier si një mungesë të periudhës së studimeve të mia, një lëndë, e cila të informonte studentin e Fakultetit Ekonomik për skemën qeverisëse të shoqërisë, aktorët dhe faktorët me ndikim, në funksionimin e mirë të saj.

Fatmirësisht, ristrukturimi i programeve mësimore në Fakultetin Ekonomik, në periudhën e mbas viteve ‘90, e korrigjoi, për ta mbushur këtë boshllëk me lëndën “Bazat e qeverisjes”.

M’u dha një detyrë, që e përqafova me zell dhe me përgjegjësi.

Me këtë punim, doja të krijoja një burim informacioni tërheqës e të besueshëm.

Objektivi shumë i gjerë dhe mjaft dinamik, ma bënte të vështirë dakordësimin me veten për mbylljen e çdo kapitulli, pasi dimensionet dhe kompleksiteti i ndërlidhjeve e linin gjithmonë të hapur një derë, e kështu përfshihesha në të tjera labirinte. Gjithsesi, konceptet bazë janë dhënë, duke konsultuar dhe studiuar një listë të gjatë autorësh. Pavarësisht, kushdo i interesuar, mundet lehtësisht të vazhdojë i pavarur kërkimin dhe zgjerimin e koncepteve, sipas dinamikave të reja të zhvillimit.

Nuk ka qenë aspak e lehtë të bindesha për strukturën dhe çështjet që do të përfshiheshin në të.

Mundësia që m’u dha, me bursën që fitova për të bërë një punë kërkimore në Qendrën për Studimin e Qeverisjes Globale (CSGG), pranë London School of Economics (LSE), me projektin “Rrjeti i politikave të Europës Juglindore - Zhvillimi i njohurive strategjike dhe hulumtimi i politikave

1. Sokrati (470/469-399 p.e.s.), filozof i lashtë grek, i njohur veçanërisht për metodën e tij për të vënë në dyshim dhe sfiduar besimet e vendosura. Originaliteti i ideve dhe përplasjet e tij me shoqërinë athinase çuan në gjyqin dhe në ekzekutimin e tij duke pirë helm.

në Europën Juglindore”, krahas të tjerave, më ofroi shanset të takoj dhe të bashkëbisedoj me shumë profesorë për këtë libër, të cilët ma mbështetën idenë, por dhe ndihmuan për të rafinuar strukturën.

Shkrimi i këtij libri ka qenë një udhëtim shumë pasurues, në aspektin akademik, por dhe të njerëzve të mrekullueshëm që munda të takoj dhe të njoh, të cilët më kanë ndihmuar përgjatë tij.

Në këtë moment, do të doja të falënderoja të ndjerin prof. David Held, co-director i Qendrës gjatë kohës kur realizohej projekti. Dëgjimi i tij plot durim ndaj ideve që kisha, reagimi ndaj pyetjeve të mia dhe orientimet e tij për çështjet që duheshin përfshirë dhe që do të ishin me interes për lexuesin, ma bënë fillimin e kësaj pune më të lehtë dhe shumë më të këndshme sesa mund të kishte qenë ndryshe. Ky libër ka përfituar shumë nga komentet stimuluuese të tij. Këtë falënderim e ofroj si homazh për të.

Puna për këtë libër më dha mundësinë të takoj dhe të bashkëbisedoj me ish-rektorin e LSE-së, prof. Anthony Giddens, i cili, po ashtu, tregoi gatishmëri për të më takuar dhe për të diskutuar kryesisht për temën shumë të gjerë të shtetit, por me këshilla të vyera dhe në kuptimin e institucioneve e më tej.

Ndiej mirënjohje për koordinatoren e projektit Vesna Bojicic-Dzelilovic, e cila, në takimet e shumta që bëmë, gëzohej sikundër unë, sa herë ndaja emocionet, por dhe ndrojtjet e mia para ose mbas takimeve që më mundësonte me emra të rëndësishëm profesorësh atje, sikundër dhe shqetësimet që ndanim për sfidat e shumta të nënës studiuese.

Një falënderim të përzemërt kam për Iavor Rangelov, atëherë në cilësinë e një studenti doktorant, që administronte projektin. Sensi i tij humorit dhe aftësia për të organizuar jetën e neve vizitorëve, në mënyrë aq shembullore, mbetet një ndjesi shumë e këndshme për mua!

Thellësisht mirënjohje Marselës dhe Edit, për prezencën dhe ndihmën e tyre bujare. Faleminderit që pranuat të ishit me mua dhe më ndihmuat, kur po luftoja me sfidat teknike, që ishin përtej aftësive të mia!

Fjalët nuk mjaftojnë për mirënjohjen e thellë për profesoreshën time të vyer të studimeve universitare, prof. Saemira Pino, e cila, pa asnjë hezitim, pranoi të shikonte pjesë të dorëshkrimit, përpos impenjimeve të shumta në ditën e saj. Pranimi aq zemërqeshur për të parë dorëshkrimin, por, mbi të gjitha, serioziteti shembullor për të mos anashkuar asnjë detaj, u bënë një tjetër shkollë për mua.

Nuk mundem të mos e falënderoj edhe këtu Enkeledën, për komentet e dobishme dhe për mbështetjen profesionale.

Ndiej të përcjell vlerësimin tim për kënaqësinë e pamasë intelektuale gjatë bashkëbisedimit me Përparim Kabon. Shumë bujarisht diskutuam dhe ndamë ide, por më së shumti e dëgjoja, sepse me shumë endje dukej sikur të shëtiste në “kështjellën” e mendjeve të ndritura, për të cilat ai fliste me aq shumë kompetencë e pasion.

A mundem të mos shprehem falënderuese për studentët e mi, debatet dhe komentet stimuluuese të të cilëve ngacmonin reflektimin tim, e sidomos për ata, që merrnin iniciativat për të më bërë sugjerime të ndryshme për librin, i cili u është ofruar në formën e leksioneve? Ju jam gjithmonë mirënjohëse për çdo situatë, e cila, sido që të emërtohet, ka vulën e pafajësisë së moshës në të cilën jeni.

Nëse puna ime e gjatë po finalizohet me këtë produkt, është vetëm falë edukimit dhe shembullit personal të dy prindërve të mi të shtrenjtë, të patrembur, bujarë dhe shumë punëtorë. Një incident elektronik ma humbi para disa viteve gjithë sa kisha shkruar! U trondita shumë dhe më dukej sikur nuk do t'i kthehesha më asnjëherë këtij shkrimi, por vazhdimisht ndieja zërin e tyre, që më thoshte: "Dështim është kur nuk di të kapërcesh humbjen". Gjithmonë falënderuese për gjithçka bënë dhe më ofruan!

Fjalët e mia të fundit janë për djalin tim, që është, në fakt, "gjëja" ime e parë.

Ndiej se i kam lënë shumë gjëra mangët, sa herë zhytesha në kërkime e lexime dhe, edhe pse isha pranë tij, jo gjithmonë kam qenë me të. E tani, i rritur dhe i diplomuar në Shkencat Politike, m'u bë një konsulent i mirë, por dhe redaktues i shumë çështjeve. Faleminderit, biri im!

Libri kujdeset të shuajë kërshtërinë e kësaj kategorie lexuesish:



Për këdo, me ndjenjë kurioziteti dhe etje për të pasur një kuptim më të thellë, përtej emërtimeve apo terminologjive që dëgjojmë ose hasim në jetën tonë të përditshme, shpesh pa ua kuptuar plotësisht kuptimin dhe rolin e tyre për jetën tonë;



Kushdo që kërkon një kuptim praktik të qeverisjes dhe strukturave të ndërlikuara sociale dhe politike brenda shoqërisë sonë;



Studentët që ndjekin studimet në menaxhimin e sektorit publik ose në fusha të ngjashme;



Individë në poste ekzekutive ose joekzekutive, të langazhuar në organizata të ndryshme publike dhe joqeveritare;



Individë me përvojë, që mbajnë role drejtuese e kërkojnë një referencë gjithëpërfshirëse mbi faktorët socialë dhe politikë që ndikojnë në një vend.

Edhe pse ka një strukturë logjike e realisht fiton prej tij nëse lexohen kapitujt me radhë, kushdo që do ta përdorë librin, mund t'u drejtohet atyre çështjeve që i duken më intriguese apo më afër interesave.

Në mbyllje, është dëshira ime e përzemërt, që njohuritë brenda këtyre faqeve të ndihmojnë sadopak për të kuptuar rrjetin e ndërlikuar të qeverisjes në kohët në të cilat jetojmë.

PËRMBAJTJA

PJESA E PARË

KONTEKSTI HISTORIK.....	13
KAPITULLI 1	15
SHTETI NËPËR SHEKIJ: Nga Origjina në Modernitet	17
KAPITULLI 2	63
TË KUPTOJMË QEVERISJEN	65
KAPITULLI 3.....	111
INSTITUCIONET - Skema e Organizimit Shoqëror:	
Në kërkim të thelbit të qeverisjes – Kultura dhe Normat	113
KAPITULLI 4.....	147
REGJIMET POLITIKE: Kuptimi i spektrit të qeverisjes.	149

PJESA E DYTË

STRUKTURA DHE INSTITUCIONET KOMBËTARE	195
KAPITULLI 5.....	197
KUSHTETUTA DHE SKEMA QEVERISËSE	199
KAPITULLI 6	243
LEGJISLATURAT: Përtej ligjbërjes dhe përfaqësimit	245
KAPITULLI 7.....	273
TERRITORI EKZEKUTIV: Dominimi dhe Përgjegjësia	
në Qeveri	275

KAPITULLI 8.....	313
PUSHTETI I VENDOSJES SË DREJTËSISË	315
KAPITULLI 9	353
BUROKRACIA: Si punon qeveria?	355
KAPITULLI 10	399
QEVERISJA ME SHUMË NIVELE	
Bashkimi European dhe qeverisja globale	401
KAPITULLI 11	441
NIVELI I LOKAL I QEVERISJES: Potenciali i qeverisjes	
së udhëhequr nga komuniteti	443

PJESA E TRETË

AKTORËT POLITIKË	489
KAPITULLI 12	491
PARTITË POLITIKE DHE MEDIA: Formimi i një demokracie	
bashkëpunuese	493
KAPITULLI 13	543
GRUPET E INTERESIT	545
KAPITULLI 14	587
SHOQËRIA CIVILE - Si sferë publike.....	589
 FJALORTH	 629
MBI AUTOREN	637

SHKURTESA

OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
OGP	Open Government Partnership / Partneritet Qeveritar i Hapur
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
OJQ	Organizatat joqeveritare
DGB	Konfederata e Sindikatave Gjermane
TUC	Kongresi i Sindikatave të Britanisë
BSPSH	Bashkimi i Sindikatave të Pavarura Shqiptare
KSSH	Konfederata e Sindikatave Shqiptare
NRA	Shoqata Kombëtare e Pushkëve
BE	Bashkimi European
CAP	Politika e Përbashkët Bujqësore
OSHC	Organizatat e shoqërisë civile
WGI	Worldwide Governance Indicators/ Treguesit e qeverisjes në mbarë botën
ANRR	Analiza e ndikimit rregullator
OECD	Organizata për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ekonomik
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
QRP	Qeveria e re publike
IA	Inteligjenca artificiale
BRSS	Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike
OBT	Organizata Botërore e Tregtisë
ECSC	European Coal and Steel Community/ Komuniteti European i Qymyrit dhe Çelikut
EEC	European Economic Community/ Komuniteti Ekonomik European
EFTA	Shoqata Europiane e Tregtisë së Lirë

ICMA	Shoqata Ndërkombëtare e Menaxhimit të Qytetit
QV	Qeverisja vendore
PR	Prag ligjor
QSHN	Qeverisja me shumë nivele
RAI	Indeksi i Autoriteteve Rajonale
LAI	Indeksi i Autoriteteve Lokale
JKFM	Juridiksione funksionale, konkurruese, të mbivendosura
SEA	Sferat e autoritetit
SOA	Akti i Vetëm European
TTIP	Partneriteti Transatlantik i Tregtisë dhe Investimeve
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut, quajtur edhe Aleanca e Atlantikut të Veriut
MRP	Menaxhimi i ri publik
EEG	Burimet e rinovueshme të energjisë
QUANGO	Quasi autonomous NGO (OJQ pothuaj autonome)
GONGO	Organizatë joqeveritare e organizuar nga qeveria
ONM	Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit
SPAK	Struktura e Posaçme Anti-Korrupsion
BKH	Byroja Kombëtare e Hetimit
KED	Këshilli i Emërimeve në Drejtësi
SCOTUS	Supreme Court of the United States (Gjykata e Lartë e SHBA-ve)
RSH	Republika e Shqipërisë
PQH	Partneriteti për qeverisje të hapur
ALI	Akti i Lirisë së Informacionit
KPK	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit

PJESA E PARË

KONTEKSTI
HISTORIK

KAPITULLI



“Qëllimi i ligjit nuk është të shfuqizojë apo të frenojë lirinë,
por ta ruajë dhe zgjerojë atë”

John Locke¹

TEMA :

SHTETI NËPËR SHEKUJ: Nga origjina në modernitet

... E CILA DO TA INFORMOJË LEXUESIN PËR: ↴

- ◆ një paraqitje të përmbledhur të ngjarjeve dhe faktorëve historikë që kontribuuan në shfaqjen e shteteve moderne dhe në evoluimin e proceseve të shtetformimit me kalimin e kohës;
- ◆ shqyrtimin e teorive të ndryshme politike, që ndihmojnë në kuptimin e natyrës dhe funksioneve të shteteve;
- ◆ sqarimin e koncepteve “shtet” dhe “qeveri”, duke ekspozuar mënyrat se si këto dy lloje organizimesh ndërveprojnë brenda një sistemi politik;
- ◆ paraqitjen e elementeve bazike të shtetit;
- ◆ shqyrtimin e sfidave kryesore me të cilat përballen shtetet moderne;
- ◆ diskutimin se si teknologjitë moderne, veçanërisht në hapësirën kibernetike, po sfidojnë nocionin tradicional të sovranitetit;
- ◆ shqyrtimin e ndikimit të ndryshimeve demografike në stabilitetin dhe zhvillimin e një vendi;
- ◆ vlerësimin e masës së ruajtjes të sovranitetit të plotë në një botë të ndërlidhur globalisht;
- ◆ vlerësimin e shkallës në të cilën koncepti “shtet” mund të konsiderohet universal në kultura dhe kontekste të ndryshme historike.

1. John Locke (1632-1704), filozof dhe mjek anglez, i konsideruar mendimtari më me ndikim i iluminizmit, i njohur dhe si babai i liberalizmit.

Me lindjen e njeriut si qenie e arsyeshme homo sapiens, filloi edhe organizimi i shoqërisë. Edhe në fazën primitive, njerëzit nuk kanë jetuar të veçuar, por në bashkësi. Një gjë që duhet theksuar është fakti se njerëzit duket se kanë qenë gjithmonë të pajisur me një kulturë ose me një mënyrë të përbashkët të të shprehurit me fjalë, me shprehje të fytyrës, me gjuhën trupi, stilin e të veshurit, përgatitjen dhe konsumimin e ushqimit e të tjera. Por, përveç kulturës, shoqëritë njerëzore karakterizohen edhe nga një organizim, i quajtur shtet, komb ose shtet-komb. Këto dy karakteristika të përgjithshme, kultura dhe organizimi, mund të konsiderohen si lënda bazë e jetës shoqërore. John A. Hall dhe G. John Ikenberry¹, që në hyrje të librit të tyre

Kombi - një grup kulturor ose etnik njerëzish, që kanë karakteristika të përbashkëta, si: gjuha, historia dhe traditat, dhe mund të kenë ose jo shtetin e tyre.

“Shteti”, vënë në dukje se “pjesa më e madhe e historisë njerëzore nuk ka qenë e zbuluar nga prania e shteteve”. Në fakt, termi “shtet”, është përdorur në mënyrë retrospektive, për t’iu referuar mekanizmave dhe proceseve të qeverisjes politike, që lindën mbi 6000 vjet më parë në Levant (Egjipti e Sumeria), por vetëm nga shekulli XVII historia njerëzore duket se është pajisur me shtetin, atë modern, sikundër e njohim sot.

Për shumicën e studiuesve², origjina e shtetit lidhet me periudhën e kalimit nga endjet e fiseve gjuetare nomade në shoqëritë agrare. Ky kalim nga një mënyrë jetese nomade (grupe gjuetarësh) në komunitetet bujqësore të fiksuar në një territor, luajti një rol vendimtar në çlirimin e potencialit njerëzor. Një ndryshim i tillë lejoi një përdorim më të organizuar dhe efikas të burimeve, duke çuar në rritjen e shoqërive dhe në zhvillimin e strukturave më komplekse sociale. Natyra relativisht e qëndrueshme e prodhimeve bujqësore, çoi në krijimin e institucioneve dhe infrastrukturës për të qeverisur, por edhe për të zhvilluar pushtetin mbi një territor që sot e lidhim me shtetin, rrethanë e krijuar fillimisht në Mesopotami, në Meso-Amerikë, në luginën e lumit Indus, në Kinë dhe në Peru dhe më pas edhe më gjerë. Për shembull, në diskutimin që Harari (1976) bën te “Sapiens”³, thekson se shteti u shfaq si një mënyrë për të menaxhuar grupe më të mëdha

1. John A. Hall dhe G. John Ikenberry (1989), *The state*

2. Shikoni më shumë: Start Hall (1986), *The Problem of Ideology-Marxism without Guarantees*; Michael Mann (1988), *States, War and Capitalism*; Sahlins (1974), *The original affluent society*; Skinner (2018) *From Humanism to Hobbes: Studies in Rhetoric and Politics*.

3. Yuval Noah Harari (2017). *Sapiens: A Brief History of Humankind*.

njerëzish. Ai prezanton konceptin e “urdhrave të imagjinuar”, që janë besime të përbashkëta që i lidhin njerëzit në shoqëri. “Dhe shteti, - thotë ai, - është një rend i tillë i imagjinuar, që ofron një kornizë për bashkëpunimin dhe kontrollin shoqëror”.

Në këto faza fillestare të zhvillimit të tij, mënyra se si shteti ushtronte pushtetin mbi popullsinë, ishte kryesisht despotike dhe shtrënguese. Në këtë kontekst bëhet i rëndësishëm një tjetër faktor: feja. Komunitetet e gjahtarëve bazoheshin në lidhjet farefisnore, por që nuk mbetën më të tilla, me organizimet agrare që i zëvendësuan. Kjo i bëri ata jo vetëm të varur nga shtrëngimi, por, në mungesë të marrëdhënieve të forta farefisnore mes njëri-tjetrit, edhe më të brishtë kur shtrëngimi kundërshtojë. Në këtë kontekst, siç e trajton historia daneze Patricia Crone (1945-2015)¹, ishte kapaciteti i fesë për t’i dhënë legjitimitet përdorimit të organizuar dhe gjithnjë e më të centralizuar të pushtetit shtrëngues (nëpërmjet thirrjeve ndaj një fuqie hyjnore) ai që bëri të mundur konsolidimin e pushtetit shtetëror, gjë që, nga ana e vet, lehtësoi zhvillimin e mëtejshëm të kapacitetit institucional për të qeverisur dhe rregulluar një territor gjeografik dhe, bashkë me të, aftësinë për mobilizime ushtarake. Pushtimi u bë shumë shpejt, mekanizmi parësor nëpërmjet të cilit u përhap forma institucionale e shtetit, pasi kapaciteti organizativ që zhvilloi shteti i dha atij një avantazh konkurrues (superior) ndaj shoqërive parashtetërore.

KUDONDODHJA E SHTETIT

Nisur nga rëndësia që ka, mund të themi se, shteti i sotëm modern është vital për jetën tonë dhe, pavarësisht aftësisë sonë për ta përkufizuar apo jo konceptin “shtet”, ai është i pranishëm si në simbolet kombëtare të flamurit apo himnit, ashtu dhe kur na vijnë faturat e fundmuajit për t’u paguar apo gjithçka tjetër, që mundëson rregullimin e jetës në shoqërinë ku jetojmë.

Kritikë të ndryshëm² e kanë dënuar gjithmonë e më shumë shtetin si joefikas, joefektiv dhe despotik, e ai, ndryshe nga kultura e njerëzve, që është diçka e qëndrueshme dhe e përhershme, konsiderohet si më i paqëndrueshëm dhe i përkohshëm. Përpos kësaj gjëja që konsiderohet pjesë e pa ndryshim, kur karakterizojmë shtetin modern, është kombinimi i njëkohshëm, nga njëra anë,

Moderne – një gjendje me karakteristika të tilla si ekonomia industriale ose post-industriale, pasuri, profesione të specializuara, lëvizshmëri të popullsisë, urbanizim dhe një popullsi e arsimuar.

1. Crone P.(2015). *Pre-Industrial Societies: Anatomy of the Pre-Modern World*

2. Për më shumë hollësi mund të vijoni me: Olson, M. (2000), *Power and Prosperity: Outgrowing Communist and Fukuyama, F. (2011), The Origins of Political Order: From Prehuman Times to the French Revolution.* Tilly, C. (1985), *War Making and State Making as Organized Crime.* Skocpol, T. (1979), *States and Social Revolutions: A Comparative Analysis of France, Russia, and China.*

- (i) i pretendimit të tij për të vepruar si pushtet publik përgjegjës për qeverisjen e një territori gjeografik të përcaktuar, dhe, nga ana tjetër,
- (ii) ndarja e tij nga ata, në emër të të cilëve pretendon se qeveris.

Shteti modern është, pra, një tërësi institucionale, që pretendon për vete sovranitetin si autoriteti suprem politik brenda një territori të përcaktuar për qeverisjen e të cilit është përgjegjës. Ai shfaqet si një tip i specializuar qeverisjeje, me këto karakteristika:

- Shteti është një institucion apo tërësi institucionesh i veçuar në mënyrë të dallueshme, pra i ndryshëm nga pjesa tjetër e shoqërisë së të krijojë sfera të identifikueshme publike dhe private.
- Shteti është sovrani ose pushteti suprem dhe autoriteti më i lartë brenda territorit të tij, dhe me përkufizim, autoriteti i fundit për të gjitha ligjet (për shembull, ligjet e vendosura garantojnë nga sanksione të forta). Legjislacioni publik hartohet nga nëpunësit shtetërorë dhe mbështetet nga një monopol formal force.
- Sovraniteti i shtetit shtrihet tek të gjithë individët e hapësirës së një territori të dhënë dhe zbatohet në mënyrë të barabartë edhe mbi ata me pozita zyrtare në qeveri apo ligjbërje. Sovraniteti, pra, dallon nga personeli, i cili në një kohë të dhënë ka një rol të caktuar brenda shtetit.
- Personeli i shtetit modern në pjesën e tij më të madhe rekrutohet dhe përgatitet për të menaxhuar në një mënyrë burokratike.
- Shteti ka aftësitë që nga popullsia e vet të krijojë të ardhura monetare (taksimi) për të financuar veprimtaritë e tij.

Këto karakteristika janë abstraksione jo njëllor të zbatueshme në të gjitha vendet moderne. Pavarësisht, ato përfaqësojnë tipare, për të cilat shumica e studiuesve të shkencave shoqërore dhe historianë do të pohonin se dallojnë shtetin modern nga sistemet e mëparshme paramoderne të qeverisjes. Në këtë përkufizim të shtetit nuk ka asgjë demokratike, me përjashtim të kërkesës formale që nënshtrimi ndaj sovranitetit zbatohet njëllor për të gjithë individët.

NË KËRKIM TË GJENEALOGJISË SË FORMIMIT TË SHTEMIT

Etimologjikisht¹, termi “shtet” rrjedh nga fjala latine “status”, që fjalë për fjalë do të thotë “pozicioni ose qëndrimi i caktuar i një individi brenda një komuniteti”. Me kalimin e kohës, ky term evoluoi për të treguar gjithashtu një entitet politik ose një formë të strukturuar qeverisjeje. Në kohë të ndryshme, kuptimi dhe emërtimi i fjalës “shtet” kanë ndryshuar. Në kohët e lashta, grekët e përdornin fjalën “shtet” në kuptimin e polisit ose të qytet-

1. Etimologjia - studimi i origjinës dhe i historisë së fjalëve, duke gjurmuar kuptimet dhe zhvillimin e tyre me kalimin e kohës.

shtetit. Qytetet në Greqinë e lashtë dhe në Romë ishin të vogla, të thjeshta dhe të kufizuara. Në shekullin XIV, përdorimi i termit i referohej qëndrimit ose statusit (dinjitetit) të sundimtarëve, duke i dalluar dhe veçuar ata, prej atyre që u nënshtroheshin sundimit të tyre. Formulimi karakteristik para-modern i shtetit ishte mishërimi i tij të sundimtari, duke konsideruar “shtetin” dhe “sovrantin” si sinonime¹. Në pjesën e parë të shekullit XVI, Machiavelli², ishte i pari që përdori fjalën “lo stato”. Në librin e tij “Princi” (Il Principe; 1532), shteti (lo stato) u bë sinonim jo vetëm i vetë princit, por i karakterit të regjimit politik, zonës gjeografike mbi të cilën pretendohet dhe ushtrohet autoriteti sovran, dhe ku institucioneve qeverisëse u kërkohet ta ruanin një autoritet të tillë. Makiaveli e përshkroi shtetin si një entitet politik që kërkon një sundimtar të fortë, i cili është i gatshëm të përdorë dinakërinë dhe forcën për të ruajtur pushtetin dhe stabilitetin. Shteti sipas tij është një “sistem pushteti”³.

Shtet-komb - një strukturë politike, në të cilin kufijtë e shtetit përputhen me kufijtë e një kombi specifik, që do të thotë se qeveria përfaqëson dhe i shërben atij grupi të caktuar kulturor ose etnik brenda territorit të tij.

Lëvizja politike republikane e Rilindjes⁴ mbrojti kauzën e një regjimi republikan vetëqeverisës, i cili mund të iniciojë një “shtet” ose rrethana për liri qytetare, apo “lo stato franco” - në termat e Dante Aligerit. Këtu shfaqet koncepti i një autoriteti autonom civil dhe politik, që rregullon punët publike të një komuniteti të pavarur ose të një “shteti”. Në këtë lëvizje, shteti paraqitet se pretendon dhe gëzon monopolin e përdorimit legjitim të dhunës, dhe se autoritetin për këtë pretendim e merr jo nga pushteti ose statura e sundimtarëve të tij, por nga vetë populli.

Për herë të parë, shteti përmendet si një aparat i veçantë qeverisjeje, të cilin sundimtarët kishin për detyrë ta ruanin. Ky ndryshim ndodhi sepse besohej që sundimtarët kishin një autoritet natyror/të lindur dhe ky autoritet u përdor për të krijuar dhe mbajtur shtetin. Në të kaluarën, sundimtarët shiheshin si fokusi kryesor i pushtetit, por tashmë ky fokus u zhvendos te vetë shteti, i cili shihej si i qëndrueshëm edhe kur sunduesit ndërroheshin. Kjo është një pikë kthese e rëndësishme për mënyrën se si njerëzit mendonin për qeverinë dhe shtetin.

Mesjeta dëshmoi dominimin e feudalizmit, ku zotërit lokalë kishin pushtet të konsiderueshëm mbi territoret e tyre. Sistemi feudal i la vendin shfaqjes së shtetit-komb gjatë periudhave të Rilindjes dhe Iluminizmit. Koncepti “shtet-komb” theksoi sovranitetin e një territori të përcaktuar me një qeverisje të centralizuar, duke shënuar një ndryshim të rëndësishëm në organizimin politik.

1. J.H. Shennan (1974), *The origins of the modern European state, 1450–1725*.

2. Niccolò Machiavelli, filozof italian i Rilindjes dhe teoricien i politikës.

3. Machiavelli, N. (1961), *The Prince*.

4. Shih: Skinner Q (1978), *The Foundations of Modern Political Thought*. Viroli M (1992), *The Revolution in the Concept of Politics*.


Hapi i fundit lidhet me ngritjen e shtetit absolutist në Europën e shekullit XVII. Shteti, veçanërisht në shkrimet e Bodinit dhe Hobsit¹ konceptohet realisht, i ndarë përfundimisht nga pushteti i sundimtarit dhe i të sunduarve.

Tri aspekte dalluese, që diferencojnë dhe i japin përcaktimin shtetit modern përfshijnë: (_i_) individët brenda shoqërisë, që e paraqesin veten si subjekte të shtetit, të lidhur nga detyrat dhe besnikëria ndaj shtetit dhe jo si sundimtar; (_ii_) autoriteti i shtetit është i vetëm dhe absolut; dhe (_iii_) shteti konsiderohet si forma më e lartë e autoritetit në të të gjitha çështjet e qeverisjes civile². Shekujt XIX dhe XX panë zgjerimin e shteteve-kombe, përmes proceseve si kolonizimi dhe dekolonizimi, duke çuar në krijimin e shumë vendeve të pavarura. Ndërkohë, konfliktet globale dhe ndryshimi i ideologjive, si nacionalizmi dhe socializmi, luajtën role kryesore në riformimin e dinamikave shtetërore.

Në epokën bashkëkohore, globalizimi dhe teknologjia digjitale kanë sfiduar kufijtë tradicionalë të shtetit, duke lehtësuar ndërlihdjen dhe duke ndikuar në funksionet e shtetit. Ndërsa shteti-komb mbetet një njësi politike themelore, diskutimet rreth përshtatshmërisë së tij përballë këtyre dinamikave të reja vazhdojnë, duke theksuar evolucionin e vazhdueshëm të proceseve të shtetformimit.

Në vitin 1800 kishte vetëm 19 shtete, kryesisht në Europë dhe Azi. Deri në vitin 1900, numri u rrit në mënyrë modeste me rreth 30 shtete të tjera, kryesisht në Europë dhe në Amerikë. Faza më dinamike e formimit të shtetit ndodhi pas Luftës së Dytë Botërore, veçanërisht gjatë dekolonizimit, i cili çoi në pavarësinë e afro 70 shteteve afrikane dhe aziatike në vitet 1960 dhe 1970. Më shumë shtete të reja u shfaqën pas shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik në vitin 1991, për të arritur në shifrën e 195 (shikoni sqarimin tek tabela 1.1), shteteve aktualisht.

Tabela 1.1



1. Vigani/ Leviathan i Hobbes (1651 [1968]) dhe ngritja e shtetit absolutist që pasqyron kjo vepër, shënon fundin e konceptit paramodern të shtetit në të cilin pushteti politik kuptohet në terma personalë dhe frymëzues. Shteti tani shihet si një formë e veçantë autoriteti, e pavarur nga ata që i japin efekt dhe realizojnë pushtetin e tij.

2. Skinner, Q. (1989), *Liberty before Liberalism*.

Kjo trajektore historike nënvizon ndikimin që kanë ndërveprimet komplekse të forcave politike, sociale dhe teknologjike në formësimin e shtetit modern.

NEVOJA E NJË PËRKUFIZIMI

Nevoja për ta përkufizuar shtetin është e domosdoshme. Në rastin konkret, përkufizimi nuk reduktohet thjesht në gjetjen dhe vendosjen e disa termave, pasi shteti paraqitet koncepti më problematik për studiuesit, për shkak të vështirësisë për të bërë një përcaktim përfundimtar për të. Përkufizimi i shtetit është ngacmuar kryesisht nga këto dy pyetje kryesore:

E para, me natyrë më normative: çfarë duhet të jetë dhe çfarë duhet të bëjë shteti?

E dyta, më e bazuar në fakte: çfarë janë shtetet në të vërtetë?

Në përkufizimin e shtetit, studiuesit e shkencave shoqërore, janë dakordësuar që ai të përfshijë tri elemente:

Së pari, shteti është një grup institucionesh; këto janë të drejtuara nga vetë personeli i shtetit. Institucioni më i rëndësishëm i shtetit është ai i mjeteve të dhunës dhe detyrimit.

Së dyti, këto institucione janë në qendër të një territori të kufizuar gjeografikisht, që zakonisht quhet shoqëri. Shteti preokupohet së brendshmi për shoqërinë e vet kombëtare dhe nga jashtë për të tjera shoqëri, me të cilat bashkudhëton; vetëkuptohet, sjelljet e saj në këto dy terrene ndikojnë respektivisht njëra-tjetrën.

Së treti, monopoli shtetëror kufizohet brenda territorit të tij. Kjo sjell dhe ndikon në krijimin e një kulture të përbashkët politike¹ për të gjithë qytetarët e saj².

NATYRA NJERËZORE

Kur diskutohet lindja e shtetit, kuptimi i natyrës njerëzore ndikon në mënyrën se si studiuesit dhe shoqëritë perceptojnë nevojën për autoritet, ligje dhe institucione për të qeverisur ndërveprimet njerëzore brenda shtetit. Në kontekstin e lindjes së shtetit, koncepti i natyrës njerëzore ka qenë temë e debatit filozofik dhe politik. Shumë filozofë të hershëm studiuin natyrën e qenieve njerëzore ndërsa organizoheshin në shoqëri dhe shtete. Çështja nëse natyra njerëzore është në thelb bashkëpunuese, konkurruese, racionale, egoiste apo altruiste luajti një rol vendimtar në formësimin e teorive të qeverisjes, autoritetit dhe kontratës shoqërore.

Natyra njerëzore i referohet karakterit thelbësor dhe të pandryshueshëm të të gjitha qenieve njerëzore. Termi në vetvete nënkupton se ekzistojnë

1. Kultura politike karakterizon tërësinë e besimeve, vlerave, traditave dhe praktikave, që përbëjnë dhe bazën e një sistemi politik.

2. J.A Hall & G John Iknberry(1989), *The State*.

disa cilësi, prirje dhe tipare themelore, që janë të qenësishme për të gjithë individët, për shkak të të qenit njerëzorë. Këto cilësi konsiderohen si të pandryshueshme, pavarësisht nga faktorët e jashtëm si kultura, shoqëria ose konteksti historik.

Thomas Hobbes (1588-1679), filozof anglez me mjaft ndikim në shekullin XVII, dha një përkufizim të spikatur të shtetit. Në shkrimet e tij, ideja e një “gjendjeje natyrore” u përdor për të eksploruar se si mund të kenë ndërvepruar qeniet njerëzore përpara krijimit të shoqërive dhe shteteve të organizuara.

Për Hobsin, në gjendjen natyrore, njerëzit janë udhëhequr nga interesi vetjak dhe prirja për vetëmbrojtje, që u jepte atyre të drejtën e natyrshme për të ruajtur veten. Konflikti dhe pasiguria e qenësishme që krijohej, do të shkaktonin një ekzistencë kaotike dhe potencialisht të dhunshme. Ishte ky instinkt egoist për mbijetesë, që diktoi parandalimin e kësaj situate, nëpërmjet të ashtuquajturës “kontratë sociale”, ku individët, me dëshirë, heqin dorë nga disa prej të drejtave dhe lirive të tyre natyrore, për t’ia dhënë ekskluzivisht kontrollin e forcës një autoriteti qeverisës, në këmbim të mbrojtjes dhe vendosjes së paqes dhe rregullit (*një përmbledhje të arsyesimit të tij mund ta shikoni në leximet plotësuese*). Ky veprim zëvendëson çrregullimin me organizimin dhe krijon mundësinë që njerëzit të bashkëpunojnë për përfitime reciproke. Këtë autoritet të fortë qendror, ai e quajti Vigan¹ për t’iu referuar një qeverie apo shteti të fuqishëm dhe gjithëpërfshirës. Pra, sipas Hobsit, funksioni parësor i shtetit është ruajtja e rendit dhe parandalimi i “luftës së të gjithëve kundër të gjithëve” që ekziston në gjendjen natyrore².

Mekanizmat e stabilitetit shoqëror sipas Hobsit

Argumentimi i Hobsit për domosdoshmërinë e qeverisjes në ruajtjen e stabilitetit shoqëror:

1. Barazia njerëzore dhe aftësia për të dëmtuar:

Thomas Hobbes fillon duke pohuar se, në thelb, të gjithë njerëzit janë të barabartë në aftësinë e tyre për t’u shkaktuar dëm të tjerëve.

2. Ambicia dhe frika nga sulmi:

Për shkak të kësaj barazie të qenësishme, lindin konflikte midis individëve. Dëshira për të arritur qëllimet personale, e kombinuar me frikën e dëmtimit të mundshëm nga të tjerët, çon në përplasje interesash, duke krijuar një gjendje tensioni.

3. Formimi i armiqve dhe rivaliteti:

Kur dy ose më shumë individë dëshirojnë të njëjtën gjë, por jo të gjithë mund ta kenë, ata bëhen armiq. Ky rivalitet nxitet nga nevoja e vetëmbrojtjes dhe kënaqësisë personale, edhe nëse sjell shkatërrim ose mposhtje të njëri-tjetrit.

1. Leviathan është përbindësh i detit në Testamentin e Vjetër, i cili përdoret shpesh në mënyrë metaforike për të përfaqësuar diçka të madhe dhe të fuqishme.
2. Hobbes, T. (1651), *Vigani* / (*Leviatani*).

4. Nevoja për autoritet dhe rend:

Në mungesë të një autoriteti qeverisës, - argumenton Hobbes, - mbizotëron një gjendje e kushteve të ngjashme me luftën, ku të gjithë janë kundër të gjithëve. Kjo gjendje anarkie çon në kaos, pasiguri dhe në një kërcënim të vazhdueshëm për mbijetesën.

5. Krijimi i një pushteti të përbashkët:

Për t'i shpëtuar kësaj situatë kaotike, njerëzit bien dakord të krijojnë një pushtet të përbashkët, i cili mund t'i mbrojë ata nga kërcënimet e jashtme dhe konfliktet e brendshme. Ky pushtet i përbashkët është zakonisht një kuvend apo qeveri e centralizuar me autoritetin për të marrë vendime në emër të komunitetit.

6. Dorëzimi i pushtetit individual:

Që ky pushtet i përbashkët të jetë efektiv, individët duhet t'ia dorëzojnë atij pushtetin dhe forcën e tyre individuale. Ky delegim kolektiv i autoritetit siguron që vullnetet individuale të unifikohen dhe të përputhen me vendimet e marra nga organi drejtues.

7. Krijimi i një commonwealth-i:

Rezultat i kësaj marrëveshjeje është krijimi i "commonwealth"-it. Ky term i referohet entitetit politik, tek i cili individët bashkohen dhe dorëzojnë pushtetin e tyre duke i dhënë autoritet një organi qendror për të vendosur rendin, për të mbrojtur interesat e tyre dhe për të ruajtur paqen dhe stabilitetin shoqëror.

John Locke (1632-1704), një tjetër filozof anglez i po të njëjtës periudhë, prezantoi këndvështrimin e tij mbi shtetin në veprën e tij "Dy traktatet e qeverisjes". Në këtë vepër ai propozoi një opsion të tij mbi marrëveshjen shoqërore, duke sugjeruar se njerëzit mblidhen për të formuar një shoqëri politike dhe për të krijuar një qeveri, që të mund të mbrojnë të drejtat e tyre natyrore, si jeta, liria dhe prona. Ata, sipas tij, hyjnë në këtë kontratë me dëshirë për t'i shpëtuar gjendjes së natyrës, ku mund të përballen me konflikte dhe pasiguri. Locke argumentoi se qeveritë e sigurojnë autoritetin e tyre nga pëlqimi i të qeverisurve dhe si qëllim kryesor kanë mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve. Ai theksoi idenë se qeveritë duhet të jenë të kufizuara në kompetencat e tyre dhe nuk duhet të cenojnë të drejtat individuale. Nëse një qeveri nuk arrin të përmbushë detyrën e saj për të mbrojtur të drejtat ose bëhet tiranike, qytetarët kanë të drejtë t'i rezistojnë apo edhe ta rrëzojnë atë.¹ Ndryshe nga Hobs, që e shihte shtetin si një autoritet të nevojshëm për të parandaluar kaosin në një gjendje të ashpër natyrore, për Locke shteti ishte mbrojtës i të drejtave individuale, i formuar ky përmes një kontrate shoqërore vullnetare.

Filozofë si **Jean-Jacques Rousseau** kishin një pikëpamje më pozitive për natyrën njerëzore në gjendje natyrore. Ruso besonte se njerëzit e hershëm ishin të vetëmjaftueshëm dhe nuk kishin dëshira që t'i çonin në konkurrencë

Të drejtat natyrore
- të drejta për jetën,
lirinë dhe pronën,
që ekzistojnë
pavarësisht qeverisë.

1. Locke, J. (1690), "Dy traktatet e qeverisë".

dhe konflikt. Sipas tij, kontrata shoqërore ishte një bashkim vullnetar për të formuar një shtet që përfaqëson vullnetin e tyre të përbashkët dhe synon të mbrojë interesat e tyre kolektivë. Në këtë këndvështrim, individët heqin dorë nga liria e tyre natyrore në favor të lirisë civile, e cila siguron që të gjithë të respektojnë ligjet që ata krijojnë kolektivisht.

Shteti sipas G. Hegel (1770-1831)¹. Në teorinë politike të Hegelit² koncepti i shtetit luan një rol qendror. Ai e sheh shtetin si një entitet organik, që mishëron shpirtin dhe vullnetin kolektiv të shoqërisë që ai drejton. Kuptimi që ai ka për shtetin është i shumanshëm dhe mund të shihet nga dy këndvështrime:

Së pari, shteti i referohet tërësisë së rendit shoqëror. Në këtë këndvështrim, ai përfshin organizimin kolektiv të një shoqërie, duke përfshirë institucionet, normat dhe praktikën e tij, pra një kornizë gjithëpërfshirëse, që rregullon marrëdhëniet dhe ndërveprimet ndërmjet individëve dhe grupeve brenda një komuniteti ose kombi të caktuar. Ai mishëron parimet dhe vlerat themelore që formojnë dimensionet etike, ligjore dhe kulturore të shoqërisë.

Së dyti, shteti “politik”, i cili i referohet aparatit institucional përgjegjës për ushtrimin e pushtetit politik dhe administrimin e çështjeve publike. Ai përfshin qeverinë, organet legjislative, organet administrative dhe strukturat e tjera të përfshira në formulimin dhe zbatimin e ligjeve dhe politikave.

Për Hegelin, shteti ishte kulmi i zhvillimit të rëndeve racionale³, zhvillim ky që përfshin dhe dy institucione të tjera të rëndësishme: familjen dhe shoqërinë civile, dy hallka të tjera të dallueshme brenda kornizës më të madhe shoqërore. Me fjalë të tjera, familja, shoqëria civile dhe shteti janë të ndërlidhura dhe së bashku formojnë strukturën e plotë shoqërore, secila duke i shërbyer qëllimit të vet dhe duke kontribuar në funksionimin e së tërës.

Kuptimi i shtetit të Hegelit nuk kufizohet në një entitet të thjeshtë burokratik ose në një strukturë pushteti hierarkik. Për Hegelin, shteti luan një rol vendimtar në formësimin dhe organizimin e marrëdhënieve njerëzore brenda një shoqërie të caktuar.

PËRKUFIZIMI VEBERIAN I SHTETIT MODERN

Përgjithësisht pranohet se kuptimi që Maks Weber (1864-1920) ofron për shtetin, është më cilësori. Për të shteti modern ishte një formë e veçantë

-
1. Georg Wilhelm Friedrich Hegeli, filozof gjerman, që zhvilloi një sistem gjithëpërfshirës mendimi, që synonte të pajtonte kontradiktat dhe të eksploronte natyrën dinamike të realitetit përmes lenteve të arsytimit dialektik.
 2. Kryesisht në veprat e tij: “*The Philosophy of Right*”, “*Lectures on the Philosophy of World History: Introduction*”.
 3. Shlomo Avineri, *Hegel’s Social and Political Thought: The Philosophy of Objective Spirit*.

shteti, i cili, në vetvete, ishte një formë specifike e një kategorie më të përgjithshme të shoqatave politike.

Weber e përkufizoi shtetin jo sipas funksioneve të tij, por në kuptimin e “modus operandi”, pra duke e parë atë në aspektin e organizimit dhe vendosjes së mjeteve të shtrëngimit dhe forcës fizike. Në vitin 1919 Weber shkruan: “Shteti është një komunitet ose bashkësi njerëzore, që (në mënyrë të suksesshme) shpall monopolin e përdorimit legjitim të forcës fizike brenda një territori të dhënë”¹.

Dy aspekte të këtij përkufizimi janë veçanërisht të rëndësishme:

Së pari, shteti për Weber-in është një grup institucionesh me një personel të përkushtuar;

Së dyti, Weber-i e konsideron shtetin modern si një monopol të vendimmarrjes autoritare brenda një territori të kufizuar, mbështetur nga monopoli i mjeteve të dhunës fizike.

Në përkufizim, spikasin katër elemente të ndërlidhura:

- ↳ monopoli
- ↳ territori
- ↳ legjitimiteti dhe
- ↳ forca

Secili prej këtyre katër attributeve, formon një tërësi të ndërlidhur, që do të thotë se është e pamundur që një shtet të ekzistojë pa praninë e secilës prej këtyre karakteristikave. Mes tyre, forca mund të veçohet si një nga karakteristikat më dalluese, pasi ajo nuk është vetëm një tipar që kontribuon në lidhshmërinë, por edhe një element që i jep përkufizimit të Weber-it strukturën e tij. Aftësia e shtetit për të përdorur forcën në mënyrë të kontrolluar dhe të organizuar e veçon atë nga format e tjera të organizimit shoqëror dhe e lejon atë të ruajë rendin shoqëror dhe të mbrojë interesat e qytetarëve të tij. Shteti është forcë, - thoshte Xhorxh Uashington, - dhe, ashtu si zjarri, është një shërbëtor i rrezikshëm dhe një zot i frikshëm.

Ushtrimi i autoritetit nga shteti përfshin përdorimin legjitim të pushtetit shtrëngues, i cili mund të variojë nga forma relativisht të buta të zbatimit administrativ deri në veprime më të rënda si burgimi, madje edhe përdorimi i forcës ushtarake në raste ekstreme. Autoriteti i shtetit për të përdorur forcën bazohet në rolin e tij të njohur si entitet legjitim qeverisës brenda territorit të tij, gjë që nxjerr në pah aspektin unik dhe thelbësor të sovranitetit të shtetit. Autoriteti shtetëror ka disa karakteristika dalluese:

Së pari, ai është i kufizuar në një territor të përcaktuar, duke mbrojtur sovranitetin brenda kufijve të tij dhe duke rregulluar lëvizjen e njerëzve dhe mallrave.

1. Max Weber(2021), Politics as a Vocation.

Së dyti, juridiksioni shtetëror është universal brenda kufijve të tij, ai shtrihet tek të gjithë banorët e tij nëpërmjet nënshtetësisë, që sjell të drejta dhe përgjegjësi.

Së treti, shtetet ushtrojnë juridiksion të detyrueshëm, që do të thotë se shumica e individëve i nënshtrohen autoritetit të një shteti ose për shkak të lindjes brenda kufijve të tij, ose si rezultat i pushtimit. Shpesh, autoriteti shtetëror nuk është një marrëveshje vullnetare, por një kusht i vendosur mbi individët për shkak të vendlindjes ose ngjarjeve historike si pushtimet.

Së fundi, autoriteti shtetëror zbatohet përmes detyrimit, ku shteti zotëron mjetet për të siguruar bindje dhe ndëshkim për shkeljet. Max Weber e lidhte shtrëngimin me sovranitetin shtetëror.

Pavarësisht, sikundër shikohet, Weber nuk e "redukton" shtetin të forca, sepse forca ndërton shtetin vetëm atëherë kur kjo forcë është gjithashtu e legjitimuar, e monopolizuar dhe e përqendruar në një territor të caktuar.

Shteti - përfshin më shumë se vetëm pushtetin fizik; në kontekstin modern, ai përkufizohet si një "ent juridik dhe politik me pesë elemente bazë: qeverisjen, popullsinë, legjitimitetin, territorin dhe sovranitetin" (në vijim do të trajtohen më gjerë).

Situata në Republikën e Kosovës ekspozon sfidat e shtetësisë në një kontekst global.

Pavarësia e vetëshpallur e Kosovës nga Serbia në vitin 2008 çoi në një debat kompleks rreth shtetësisë, përdërisa disa vende dhe organizata ndërkombëtare e kanë njohur Kosovën si shtet të pavarur, të tjerat, përfshirë Serbinë dhe Rusinë, nuk e njohin sovranitetin e saj.

Kosova kërkon njohjen si shtet i pavarur. Ajo posedon shumë nga karakteristikat e një shteti, duke përfshirë pasjen e një qeverie, popullsi, territor dhe një shkallë legjitimiteti, por sovraniteti i saj dhe njohja ndërkombëtare mbeten të kontestuara. Çështja nëse Kosova është një shtet plotësisht sovran apo një entitet autonom brenda kornizës së Serbisë vazhdon të jetë ende temë e një debati intensiv.

Debatet rreth shtetësisë së Kosovës ngrenë çështje më të gjera për vetëvendosjen, të drejtat e pakicave dhe rolin e aktorëve ndërkombëtarë në përcaktimin e statusit të një territori. Rasti i Kosovës, gjithashtu, thekson tensionet ndërmjet sovranitetit kombëtar dhe parimeve të integritetit territorial dhe ligjit ndërkombëtar.

Nëse gjithçka do të ishte sikundër përcaktohet, çdo metër katror e territorit në këtë planet do ishte pjesë e një shteti. Ndërkohë që shumë vende janë të organizuara si shtete, ka përjashtime, si: Hong - Kongu, Palestina, Tajvani, Kosova e të tjera, të cilave u mungojnë disa cilësi të një shteti, si dhe ish-koloni dhe territore të mbetura pa sovranitet të plotë.

Shfaqja e shtetit modern u ndikua ndjeshëm nga roli i luftës dhe marrëdhënien reciproke midis luftës dhe formimit të shteteve.

Charles Tilly e përmbledh në **"Lufta bëri shtetin dhe shteti bëri luftën"**.

Shpikja e barutit në shekullin XIV transformoi shtrirjen dhe taktikat ushtarake.

Lufta luajti rol kryesor në formësimin e shtetit, sepse imponoi kërkesa për konsolidimin e pushtetit, burimeve dhe autoritetit brenda një territori të përcaktuar. Nevoja për të mobilizuar burimet për përpjekjet e luftës i detyroi sundimtarët të centralizonin kontrollin dhe të krijonin struktura administrative më të fuqishme. Ky centralizim u mundësoi atyre të ngrinin ushtri, të mbliqnin taksa dhe të zbatonin politika në mënyrë më efikase, duke forcuar kështu autoritetin e tyre. Nga ana e vet, formimi i shtetit çoi, gjithashtu, në rritjen e kapacitetit për luftë. Në këtë marrëdhënie simbiotike, lufta nxiti nevojën për shtete më të forta, dhe shtetet më të forta, nga ana tjetër, lehtësuan një luftë më të efektshme.

Nëse lufta e dobësoi shtyllën feudale të kohës së mesjetës, Reformacioni shkatëroi themelet fetare të tij.

Reformacioni i ideuar nga reformatoret protestantë, udhëhequr nga Martin Luter, sfidoi korrupsionin e kishës dhe prishi bashkimin e krishterë, duke shkaktuar konflikte midis sundimtarëve protestantë dhe atyre katolikë.

Paqja e Vestfalisë e vitit 1648 shënoi fillimin e sistemit modern shtetëror, duke i dhënë fund Luftës Tridhjetëvjeçare dhe Luftës Tetëdhjetëvjeçare, duke riformuar kufijtë shtetërorë europianë, duke ripërcaktuar sovranitetin dhe duke vendosur sistemin Vestfalian.

Ky traktat kontribuoi në idenë e shteteve si entitete të dallueshme me kufij të përcaktuar dhe sovranitet të brendshëm.

Filozofi Jean Bodin propozoi një autoritet të vetëm sovran përgjegjës për funksionet kryesore brenda shoqërisë, ndërsa John Locke theksoi të drejtat natyrore të qytetarëve, nevojën për mbrojtjen e këtyre të drejtave përmes ligjit dhe të drejtën për t'u rezistuar sundimtarëve që shkelin këto të drejta.

Revolucioni Amerikan i dha pavarësinë nga Britania, duke krijuar një republikë të re të bazuar në interpretimin liberal të Locke për shtetin, me theksin se qeveritë e marrin autoritetin e tyre legjitim nga pëlqimi i të qeverisurve. Megjithatë, ishte Revolucioni Francez i 1789-s që i shtyu kufijtë e sovranitetit duke u përpjekur ta ripërcaktojë atë në terma demokratikë dhe jo vetëm në terma liberalë. Ky revolucion, i konsideruar si një moment kyç në historinë e qeverisjes, hodhi themelet për demokracinë moderne, duke mbrojtur një shtet të centralizuar, unitar, që shpreh të drejtat e barabarta të qytetarëve brenda një komuniteti kombëtar. Këto koncepte transformuese vazhduan të evoluojnë gjatë shekullit XIX.

Për **Bill Jordan**, shteti është një sistem marrëdhëniesh që përcaktojnë territorin dhe anëtarësimin në një komunitet, rregullon çështjet e brendshme, vendos marrëdhënie me shtete të tjera (me mjete paqësore apo luftarake) dhe i jep atij identitet dhe tërësi unike. Ai përbëhet nga institucione mjaft të larmishme dhe komplekse, që operojnë sipas parimeve të ndryshme në sfera të ndryshme të komunitetit, duke ofruar kështu të mira të ndryshme shoqërore. Shteti pra, sipas tij, nga njëra anë, duhet kuptuar si mënyra që përdor shoqëria për të kontrolluar veten e duke u kujdesur që askush tjetër

të mos e kontrollojë atë, e, nga ana tjetër, si një lloj “*protection racket*”¹, që nëpërmjet përdorimit të forcës, deklaron një monopol². Sqarohet më tej këtu se, përdorimi metaforik i termit nga Jordan, sugjeron që kërkesa e shtetit për burime mund të shihet si shtrënguese, e ngjashme me mënyrën se si “mbrojtja nga raketat” i detyron individët ose bizneset të paguajnë për sigurinë e tyre. Ajo nxjerr në pah mënyrat komplekse dhe të ndryshme në të cilat njerëzit mund ta perceptojnë shtetin dhe funksionet e tij.

Shteti modern paraqitet me një autoritet të fuqishëm e me shtrirje mjaft të gjerë. E gjitha kjo ka nxitur diskutime të forta dhe mosmarrëveshje, së pari, për natyrën e pushtetit shtetëror dhe interesave që ai përfaqëson, dhe, së dyti, në lidhje me funksionin apo rolin e duhur të shtetit: çfarë duhet bërë nga shteti dhe çfarë duhet t’u lihet individëve privatë, çka ka “prodhuar” dhe një listë të gjatë teorish, ku secila ofron perspektiva të ndryshme mbi origjinën, rritjen dhe ndikimin e shtetit.

TEORITË³ MBI SHTETIN⁴

Që në krye bëhet e qartë se nuk do të mund të ofrohet një përcaktim i vetëm e gjithëpërfshirës për konceptin shtet. Kjo, sepse shteti është një ekzistencë komplekse dhe e shumanshme, që përfshin dimensionet politike, ligjore, sociale dhe administrative të tij. Përcaktimi i tij në mënyrë gjithëpërfshirëse kërkon adresimin e roleve, funksioneve dhetributeve të tij të shumta, gjë që vështirëson, në mos pamundëson, formulimin e një përkufizimi të vetëm e përfundimtar. Në vend të kësaj, studiuesit janë marrë me shqyrtimin e aspekteve të veçanta, nga të cilat kanë rezultuar dhe teoritë e shumta për të.

Teoria liberale

Fillimisht shfaqja e teorive mbi shtetin modern, ka qenë e dominuar nga teoria liberale, me nisje të mendimtarët e kontratave sociale (pjesë e grupit të teorive vullnetare)⁵ si Hobbes dhe Locke. Këta teoricienë argumentuan se shteti lindi nga një dakordësi mes individëve për t’i shpëtuar çrregullimit të “gjendjes natyrore”. Sipas këndvështrimit liberal, shteti është një entitet neutral, që vepron si një arbitër i paanshëm midis grupeve dhe individëve të ndryshëm shoqërorë, mbron qytetarët nga njëri-tjetri dhe ndjek “të mirën e përbashkët” ose “interesin publik”.

1. Ky term, që, fjalë për fjalë, do të thotë “raketë mbrojtëse”, në kontekstin e dhënë nënkupton “mbrojtje me pagesë” ose “bandë e mbrojtjes”. Termi, me origjinë në sferën e krimit të organizuar, është një formë zhvatjeje, ku kriminelët shfrytëzojnë frikën ose cenueshmërinë e viktimave të tyre për të nxjerrë para prej tyre, në këmbim të mbrojtjes nga dëmtimet ose kërcënimet e mundshme, të sajara nga vetë ata.
2. Jordan B. (1985), *The State*.
3. Paraqitja e teorive në këtë tekst, nuk ndjek kronologjinë e shfaqjes së tyre.
4. Për më shumë mund të shikoni: Heywood, A. (2017), *Political ideologies: An introduction*. Gamble, A. (2016), *The Free Economy and the Strong State: The Politics of Thatcherism*. Palgrave Macmillan.
5. Që operon krahas teorive të lufteve (1- teoria e pushtimit Ibn Khaldun, 2- teoria marksiste e shtresëzimit ekonomik dhe 3-teoria e kufizimeve të tokave bujqësore/ Robert L. Carneiro dhe ajo e Origjinës Hyjnore).

Kjo teori themelore ka evoluar në teoritë “pluraliste” dhe “neopluraliste” të shtetit.

Pluralizmi sugjeron që pushteti politik shpërndahet midis grupeve të ndryshme shoqërore dhe jo në një elitë të vetme. Neopluralistët J.K. Galbraith (1908-2006) dhe Charles Lindblom (1917-2018)¹ në shkrimet e tyre argumentojnë jo vetëm kompleksitetin e shtetit të sotëm modern industrial, por edhe një përgjegjësi më të vogël të tij ndaj presioneve popullore nga sa sugjeron pluralizmi tradicional. Ata pranojnë ndikimin e biznesit në vendimet e qeverisë dhe agjendat ekonomike. Neopluralizmi pretendon se biznesi, si një forcë dominuese, formëson shijet e publikut nëpërmjet reklamave dhe influencën qeverinë për shkak të fuqisë së tij ekonomike.

Në vitet 1970 u shfaq një lëvizje e veçantë politike dhe ideologjike, njohur si “E djathta e re”² (tab.1.2), që përfaqësonte një këndvështrim alternativ

Tabela 1.2

E Djathta e Re:	E Djathta (tradicionale):
<ul style="list-style-type: none"> • E djathta e Re i referohet një lëvizjeje politike dhe ekonomike që u shfaq në vitet 1970 si përgjigje ndaj mangësive që po shfaqnin konservatorizmi tradicional dhe politikat liberale. • Ajo thekson ndërhyrjen e kufizuar të qeverisë në çështjet ekonomike dhe sociale, kapitalizmin e tregut të lirë, individualizmin dhe besimin te përgjegjësitë personale. Kundërshton politikat e shtetit të mirëqenies, politikat rregullatore të qeverisë dhe taksat e tepërta. • E djathta e Re është e lidhur me ekonominë neolibérale “laissez-faire”, duke mbrojtur derregullimin, privatizimin dhe reduktimin e rolit të shtetit në ekonomi. • Mbron të njëjtat vlerat shoqërore konservatore për çështje të tilla si familja, feja dhe identiteti kombëtar. • Studiues si Milton Friedman dhe politikanë si Ronald Reagan dhe Margaret Thatcher ishin ndjekës dhe zbatues të kësaj ideologjie. 	<ul style="list-style-type: none"> • E Djathta ose konservatorizmi tradicional, përfaqëson një spektër bindjesh politike që i japin përparësi ruajtjes së institucioneve, vlerave dhe normave shoqërore të krijuara (trashëguara). • Ajo vë theksin te stabiliteti, rregulli dhe vazhdimësia. Vlerëson traditën, trashëgiminë kulturore dhe lidhjet shoqërore. • Pikëpamjet e saj ekonomike shtrihen nga ndërhyrja e moderuar e qeverisë deri te politikat thelbësore ‘laissez-faire’. Mes përfaqësuesve të saj, disa mbrojnë tregun e lirë, ndërsa të tjerë mbështesin një ekonomi të përzier me ndërhyrje specifike të qeverisë që synojnë trajtimin e pabarazive sociale dhe promovimin e rregullit, strukturave dhe drejtësisë në veprimtarinë ekonomike. • Mendimtarë si Edmund Burke dhe Russell Kirk janë të lidhur me konservatorizmin tradicional.

1. Galbraith, J. K. (1985), *The Affluent Society*. Lindblom, C. E. (1977), *Politics and Markets: The World's Political-Economic Systems*.

2. Termi “e djathtë” i referohet atij pozicionimi ideologjik, që shoqërohet me perspektiva politike konservatore, që theksojnë ndërhyrjen e kufizuar të qeverisë, ekonominë e tregut të lirë, lirinë individuale dhe vlerat shoqërore tradicionale.

ndaj qasjeve konvencionale, si liberalizmi tradicional ose pluralizmi, veçanërisht lidhur me rolin e shtetit dhe ndikimit të tij në aspekte të ndryshme në shoqëri dhe ekonomi. “E Djabatja e Re”, me rrënjë në parimet liberale, u quajt e tillë për qëndrimin e saj të dallueshëm ideologjik brenda spektrit më të gjerë të krahut të djathtë, për perspektivat dhe idetë e reja që paraqiti. Ajo e shikon shtetin si një “leviathan-vetëshërbyes”, që mund të bëhet egoist dhe i tepruar në shtrirjen dhe kontrollin e tij, dhe kështu të mbysë inovacionin, sipërmarrjen dhe konkurrencën e lirë. Ajo është kundër forcave që çojnë në ndërhyrjen e shtetit dhe synon të kufizojë kontrollin e qeverisë.

Pluralizmi - sipas të cilit, grupe të shumta me interesa të ndryshëm ndikojnë në vendimet e qeverisë, ndërsa neopluralizmi, një version i përditësuar i pluralizmit, pranon rolin e grupeve të mëdha dhe të fuqishme të interesit në formësimin e politikave qeveritare.

Kjo lëvizje fitoi rëndësi me figura të tilla si Margaret Thatcher në Mbretërinë e Bashkuar dhe Ronald Reagan në SHBA, të cilët, gjatë mandateve të tyre, zbatuan politika që përputheshin me këto ide.

MARKSIZMI

Në shkrimet e Karl Marksit (1818-1883)¹ për shtetin zbulohen dy ide kryesore:

Së pari, theksimi se struktura ekonomike e shoqërisë, është baza² themelore mbi të cilën lind superstruktura³ juridike dhe politike. Pra, organizimi dhe funksionimi i ekonomisë, veçanërisht mënyra e prodhimit dhe marrëdhëniet e prodhimit, formësojnë dhe ndikojnë në zhvillimin e ligjeve, institucioneve politike dhe sistemeve shoqërore. Ai argumenton se klasa sunduese, e cila kontrollon mjetet e prodhimit, kontrollon dhe formëson gjithashtu shtetin për t’u shërbyer interesave të veta. Pra:

Ideja e dytë e Marksit në lidhje me shtetin bazohet në të kuptuarit se shteti, si institucion politik, u shërben interesave të klasës sunduese dhe funksionon si mjet i dominimit dhe kontrollit të kësaj klase.

Pikëpamja klasike marksiste mbi shtetin, siç thuhet në “Manifestin Komunist” të Marksit dhe Engelsit është se ai në thelb u shërben interesave të borgjezisë; perspektivë kjo, në kontrast të fortë me idenë

1. Kryesisht te; (i) Karl Marx, Friedrich Engels, Gareth Stedman Jones(2002), *Communist Manifest*. (ii) Karl Marx, *Critique of Hegel’s Philosophy of Right*. (iii) Marx, *Critique of Gotha Program*.
 2. **Baza**: i referohet strukturës ekonomike të shoqërisë, e cila përfshin mjetet e prodhimit (të tilla si: fabrikat, mjetet dhe burimet) dhe marrëdhëniet e prodhimit (marrëdhëniet shoqërore dhe dinamikën midis klasave të ndryshme). Baza paraqet themelin material mbi të cilin ndërtohet shoqëria.
 3. **Superstruktura**: përfshin institucionet shoqërore, politike dhe ideologjike, që dalin nga baza ekonomike. Ajo përfshin institucione të tilla si: shteti, sistemi ligjor, institucionet arsimore, organizatat fetare, mediet dhe traditat kulturore. Superstruktura reflekton dhe u shërben interesave të klasës sunduese, e cila kontrollon mjetet e prodhimit dhe dominon bazën ekonomike.